



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës
Mbledhja nr. 11
Prishtinë, më 10.04.2015, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS

Në mbledhje morën pjesë: Daut Haradinaj- kryetar, Fadil Demaku, Ganimete Musliu, Anton Quni, Rexhep Selimi, Nuredin Ibishi, Zafir Berisha dhe Qerim Bajrami-anëtarë.

Mungoi: Bojan Mitiq.

Përfaqësuesit nga Sindikata e Zjarrfikësve: Muharrem Beka- Kryetar i Sindikatës së Zjarrfikësve të Kosovës, Sami Beqiri, Xhavit Gashi dhe Eset Begaj, përfaqësues nga sindikata.

Përfaqësuesit nga Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave- Fadil Kodra-Kryeshef në AME dhe Miran Demiri.

Përfaqësuesit nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale: Ruzhdi Jashari-Mbikëqyrës kryesor shtetëror dhe Bujar Sadiku-Drejtor i administratës.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Lumnije Murati- Zyra e Presidentes së Kosovës; Valza Sadriu- QKSS, Visar Rushiti-GAP dhe Arbanë Pireva- praktikante.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Nur Çeku dhe Zarife Aliu.

Mbledhjen e kryesoi, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit të mbajtur më 30.03.2015
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit Nr. 05/L-22 për Armë;
4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit Nr. 05/L-17 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-246 për Pajisje me Armë, Municion dhe Pajisje Përkatëse të Sigurisë për Institucionet e Autorizuara Shtetërore për Siguri;
5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit Nr. 05/L-15 për Letërnjoftim;
6. Raportimi i drejtorit të Agjencisë së Menaxhimit Emergjent, z. Fadil Kodra dhe përfaqësuesve të Sindikatës së Zjarrfikësve të Kosovës;
7. Shqyrtimi i raportit vjetor të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave personale për vitin 2014;
8. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua me një ndryshim, pika 6 kalon si pikë e parë e rendit të ditës.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit të mbajtura më 30.03.2015

Procesverbali i mbledhjes së Komisionit të mbajtur më 30.03.2015 u miratua pa vërejtje.

3. Raportimi i drejtorit të Agjencisë së Menaxhimit Emergjent, z. Fadil Kodra dhe përfaqësuesve të Sindikatës së Zjarrfikësve të Kosovës

Kryetari- Javën e kaluar kemi pasur një debat si Komision për gjendjen e zjarrfikësve dhe si Komision parlamentar do të jemi të gatshëm me i mbështetur ato kërkesa të cilat janë reale e që komisioni do t'i vlerësojë në të ardhmen dhe fjalën ia kaloi të pranishmëve.

Fadil Kodra, kryeshef në Agjencinë për Menaxhimin Emergjencave- Si Agjenci për Menaxhimin e Emergjencave përbëhemi prej katër departamenteve: Departamenti Operativ, Departamenti i Parandalimit, Departamenti i Zjarrfikësve, si dhe Departamenti i Gatishmërisë. Po ashtu me ligjin e ri është edhe Departamenti për Administratë. Ne kemi edhe dy dokumente strategjike, ose plane të reagimit kombëtar dhe sistemi i integruar i menaxhimit të emergjencave. Si agjenci jemi në zhvillim, pikërisht me ligjin e ri zjarrfikësit kalojnë në kompetencën tonë, por realisht kemi hasur në disa pengesa nga ligji për financa. Agjencia i ka kryer të gjitha proceduarat.

Kryetari- Në bazë të asaj që ne e kemi marrë, deri tash ka një farë shpërputhje në hierarkinë e zjarrfikësve, një kategori paguhen nga buxheti nacional, diku janë të organizuar në brigada, diku

rreth 12 komuna të Kosovës duket që koeficienti i tyre është jashtëzakonisht i ulët, trajtimi i tyre nuk është i barabartë, pajisja me uniforma, pajisja me logjistikë, pajisja me automjete taktike të gjitha këto kanë mbetur në harresë.

Muharrem Beka- Gjendja në shërbimin e zjarrfikësve të shpëtimit në Kosovës është e rëndë, si në aspektin organizativ, teknik dhe në gjitha aspektet tjera. Ne, sot, ballafaqohemi me një gjendje jo të mirë, në mungesë të kapaciteteve të personelit dhe mungesa teknike, numri i zjarrfikësve është mbi 700, disa komuna i kanë 2 ose 3 zjarrfikës. Kërkesat e sindikatës së zjarrfikësve janë: të rregullohet statusi, që të jenë punëtorë profesionalë, jo shërbyes civilë, të nxirret një ligj i veçantë që do të rregullonte veprimtarinë e zjarrfikësve, të definohen kompetencat menaxhuese, të përmirësohen kushtet e punës, të sigurohen pajisjet për punë, të kompensohen ndërrimet e natës, festat shtetërore edhe orët jashtë orarit dhe të nivelizohet koeficienti në gjitha komunat dhe kërkojmë që të sigurohet një shujtë e ngrohtë për shkak të specifikave të punës.

Fadil Demaku- Mendoj që nga prezantimi i juaj, besoj që ne do të mund ta japim kontributin tonë si Komision parlamentar, njëra prej kërkesave ishte edhe rregullimi i statusit që ju duhet të jeni punëtorë profesionalë, e jo shërbyes civilë, dhe çështja që është më e rëndësishme mendoj që është definimi i kompetencave menaxhuese, nëse orientohemi në këto dy pika, neve do të na jepet mundësia, si Komision parlamentar ta ndryshojmë dhe plotësojmë ligjin, duke marrë praktika nga ligjet e vendeve të tjera.

Anton Quni- Të gjitha këto probleme që i elaboruat, a i shihni si probleme të prodhuara nga mungesa e ligjeve apo nga infrastruktura ligjore, mos ndoshta ligjet nuk janë funksionale, apo janë probleme të rrafshit lokal ku veprojnë këto njësi, apo në nivelin qendror, ku ka edhe emergjenca?

Rexhep Selimi- Dua ta ritheksoj edhe një herë që ju jeni në vendin e duhur për t'i ngritur disa probleme, për të pasur një nismë legjislative parlamentare, për ta pasur një ligj për zjarrfikësit e Kosovës, vazhdojmë ta konsiderojmë problem edhe çështjen e buxhetit, se në legjislaturën e kaluar ne i kemi bërë presion pozitiv Qeverisë së Kosovës, që çështja e buxhetit për zjarrfikësit të mos shkojë në këtë formë.

Zafir Berisha- Na tregoni ku janë defektet, që ne përmes rrugëve që na përcakton edhe rregullorja e punës, që të mund t'ju ndihmojmë, që ky segment shumë i rëndësishëm të jetë në binarë.

Nuredin Ibishi- A është bërë ndonjë udhëzim administrativ për zbatimin e këtij ligji dhe propozoj që ky ligj shumë shpejt të hyjë në çështje të mbikëqyrjes nga Komisioni.

Ganimete Musliu- Dua që para juve të shpreh gatishmërinë time si në Komision dhe në parlament, por edhe nga grupi parlamentar nga vij, që çdo nismë që merret për përmirësimin e kushteve të zjarrfikësve do të jetë e kalueshme nga ana jonë, për arsyeje që e dimë rolin shumë human dhe njerëzor që kanë zjarrfikësit. Mua me shqetësoj pak edhe numri i zjarrfikësve në nivel të Kosovës dhe konsideroj që në të ardhmen do ta kemi parasysh bashkërisht me juve, besoj që ky nuk do të jetë takimi i fundit, por ne të kemi një bashkëpunim më efektiv.

Miran Demiri- Do të jap statistikën se sa zjarrfikës ka në nivel të Kosovës, njësitë profesionale zjarrfikëse-shpëtimit janë të organizuara në 33 komuna me 34 njësi, duke llogaritur edhe Prishtinën që i ka 2 njësi, numri i përgjithshëm i zjarrfikësve në nivel vendi është 742, duke përfshirë këtu edhe numrin e inspektorëve të parandalimit që është 36, mosha e zjarrfikësve në nivel vendi e cila është 42 vjeçare, kurse mosha e automjeteve është 30 vjeçare, por e kemi një mjet në njësinë profesionale në Vushtrri të viteve 58', por besoj që Ministra e Punëve të Brendshme do të shpërndajë automjete, për secilën njësi nga një automjet që janë blerë me buxhet të Republikës së Kosovës. Unë sindikatën e përkrahu plotësisht, por fillimisht duhet të zbatohet ligji aktual, i cili është akoma në fuqi, për zjarrfikje dhe shpëtim, por pse nuk zbatohet kjo është një çështje tjetër. Është miratuar udhëzimi administrativ për transferin e zjarrfikësve të shpëtimit nga niveli lokal, në nivel qendror, po ashtu me të duhet të kalojë edhe buxheti nga pasqyrat buxhetore komunale të Ministrisë së Punëve të Brendshme, sipas zyrës ligjore thotë se është një mos harmonizim i ligjit për zjarrfikës-shpëtim dhe atij të menaxhimit të buxhetit të Republikës së Kosovës.

Kryetari- Pse i kemi pesë komuna pa njësi zjarrfikëse, si Komuna e Obiliqit, Komuna e Parteshit, Komuna e Novobërdës, Komuna e Ranillukut dhe Komuna e Zveçanit dhe pse ka ndarje të trajtimit të zjarrfikësve? Pse në ndonjë nivel komunal trajtohet zjarrfikësi me koeficient 7.5, kurse në komunën tjetër zjarrfikësi trajtohet me koeficient 4.3?

Miran Demiri- Buxheti nuk ka kaluar në AME, në Ministri të Brendshme. Ne nuk mundemi të formojmë njësi, edhe të numri edhe të themelimi, komunat bëjnë kërkesë, në bazë të vlerësimit të rrezikut, numrit të banorëve, përgjegjësisë territoriale, faktikisht Obiliqi e ka një marrëveshje me njësinë e zjarrfikësve në industri brenda në KEK, e kemi edhe Fushë-Kosovën e cila e ka njësinë por nuk ka objekt. Disa komuna kanë buxhet më shumë e disa më pak, por sikur të ishte transferuar ky buxhet te ne do ishte trajtuar komplet ndryshe.

Muharrem Beka- Sa i përket çështjes së koeficientit, që nga koha e UNMIK-ut zjarrfikësi kur i ka mbushur 1 deri 6 vjet punë, koeficienti është ngritur në 4.83, kur zjarrfikësi i ka plotësuar 7 vite përvojë pune është ngritur koeficienti 5.5 dhe tash në disa komuna kur është rritur përvoja e punës deri në 7 vjet, ato drejtoritë nuk e kanë ngritur këtë koeficient dhe ka mbetur ashtu.

Kryetari- Komisioni parlamentar do ta trajtojë shqetësimin tuaj, materialet i kemi pranuar, do t'i shkruajmë letër direkt Ministrit të Punëve të Brendshme për ta trajtuar këtë situatë, ta shohim në rishikim të buxhetit në qershor që është mbas dy muajve nëse mundemi me ndërhy, të paktën të kalohet kjo fazë, deri sa të fillojë planifikimi buxhetor për vitin 2016 që ne gradualisht me pa mundësin e krijimit të një ligji të veçantë për zjarrfikësit.

Xhavit Gashi- Nëse vazhdojmë me këtë situatë, besoj që nuk do të kemi shërbim të zjarrfikësve efikas dhe t'i dalin në ndihmë qytetarëve të Kosovës.

4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit Nr. 05/L-22 për Armë

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së, me vota unanime nxor këtë:

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendi të miratoj në parim Projektligjin Nr. 05/L-15 për Armë.

5. Shqyrtimi në parim i projektligjit Nr. 05/L-17 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-246 për Pajisje me Armë, Municion dhe Pajisje Përkatëse të Sigurisë për Institucionet e Autorizuara Shtetërore për Siguri.

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së, me vota unanime nxori këtë:

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit të miratojë në parim Projektligjin Nr. 05/L-17 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-246 për Pajisje me Armë, Municion dhe Pajisje Përkatëse të Sigurisë për Institucionet e Autorizuara Shtetërore për Siguri.

6. Shqyrtimi në parim i Projektligjit Nr. 05/L-15 për Letërnjoftim

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së, me vota unanime nxori këtë:

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit miratimi në parim i Projektligjin Nr. 05/L-15 për Letërnjoftim.

7. Shqyrtimi i raportit vjetor të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave personale për vitin 2014

Ruzhdi Jashari- Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave para jush është me raportin e tretë të punës, Agjencia ka 18 të punësuar shërbyes civilë dhe 5 të emëruar nga Kuvendi i Kosovës, një prej sfidave që e ka pasur viteve në vazhdim ka qenë sfida e vendosjes në institucione shtetërore, respektivisht kemi qenë në objekt privat. Tash jemi në objekt shtetëror me gjithë mungesën e hapësirave, pritet të kemi hapësira shtesë në bashkëpunim që kemi pasur me Ministrinë e Administratës Publike dhe EULEX-in, kemi fituar një mbështetje prej tyre që do të kemi hapësira shtesë, sfidë tjetër është mungesa e stafit punues. Ndërkaq te ngritja e aktivitetit të punës shihet nga opinionet, në vitin 2013. Agjencia ka pasur 4 opinione, në vitin 2014 i ka 10 opinione, këshilla në vitin 2013 ka pasur 16, tash i ka 32, këshilla nënkuptojnë vendimmarrje ligjore të mbikëqyrësve në teren, ndërkaq projektligje në vitin 2013 i ka pasur 27 projektligje, në vitin 2014 ka pasur më pak me arsyeje se Kuvendi vitin e kaluar ka shkuar në zgjedhje, kurse Agjencia ka pasur 122 ankesa në vitin 2014, në vitin 2013 ka pasur 25, pyetje përmes ueb-faqes të agjencisë janë 48 për vitin 2013, 69 për vitin 2014, inspektive kanë qenë 116, kontrollime e

janë 107% më shumë se në vitin 2013; vendimmarrje të agjencisë janë 83, transfere ndërkombëtare janë 3 vendime, autorizime për përdorimin dhënave biometrike ka qenë një vendimmarrje për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës. Një arritje tjetër është çështja e procedimit të shkelësve apo përdoruesve që kanë shkelur të dhënat e zyrtarëve dhe realisht nuk kanë korresponduar me vendimet e agjencisë. Ne i kemi proceduar në gjykatë, janë 17 raste në gjykatë, prej këtyre rasteve vetëm 1 është në favor agjencisë në raport me KEK-un, çështja e përdorimit të faturave të hapura.

Ganimete Musliu- Çka do të ndërmerrni tash e tutje me KEDS-in, pavarësisht që e keni fituar anën gjyqësore, a do të vazhdoni të këmbëngulni me kërkesën që të respektohet mbrojtja e të dhënave personale, pasi që faturat e KEDS-it vijnë në mënyrën e njëjtë, aq më keq tani në formën e paragonave sikur të arka fiskale, mirëpo gjendja nuk është më mirë as me ujësjellësin, as me kompanitë e pastrimit dhe as me Termokosin.

Fadil Demaku- Të bëhet më tepër në sensibilizimin e opinionit për rëndësinë e Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, që është shumë i rëndësishëm për vendin.

Rexhep Selimi- Ky institucion është formuar shumë herët, por ju e keni bërë një punë që në çdo raportim kemi parë ndryshime, të arritura. Duke mos pasur shumë përvojë, unë kisha ngritur disa pyetje, ne i kemi identifikuar edhe disa problem të institucioneve jopublike, siç janë bankat, ku të dhënat personale i janë dërguar ndonjë banke. Sa keni arritur t'i ndaloni këto? Ju e dini si rast ku ka pasur bankë që e ka ftuar një klient pa dijen apo dëshirën e klientit, ju e keni kartelën e gatshme, kjo i bie që i ka menaxhuar të dhënat personale në mënyrë ilegale, pyetje tjetër kisha edhe cilat kanë ngelur sfidat që vazhdojnë t'ju sfidojnë juve si Agjenci Shtetërore.

Anton Quni- Do të ishte mirë që të kemi sa ma shumë informata me problemet që ju ballafaqoheni, sidomos në fushën e infrastrukturës ligjore dhe ku mund ta japim ne si komision kontributin tonë, nëse mund po ashtu të na jepni pak më shumë informata në lidhje me përfitimet e Agjencisë nga anëtarësimet në organizatat ndërkombëtare.

Nuredin Ibishi- Në raport ceket që keni bërë inspektive në Polici, pasi e dimë që Policia ka autorizim për grumbullimin, përpunimin, shfrytëzimin edhe këmbimin e të dhënave, a ka nxjerrë policia udhëzim administrativ për këtë dhe a ka keqpërdorime të të dhënave nga policia dhe agjencitë të tjera të sigurisë, pasi keni bashkëpunim me organizatat e tjera ndërkombëtare, aspekti i keqpërdorimit të të dhënave biometrike, sidomos në rastin e kalimeve ndërkombëtare? Çështja e tretë ka të bëjë me telefoninë mobile që vazhdimisht keqpërdoret sidomos kur ishin zgjedhjet.

Qerim Bajrami- Sa punëtorë keni nga komunitetet jo-shumicë?

Ruzhdi Jashari- Me KEDS-in e kemi hapur fazën e parë në gjykatën themelore, në bazë të legjislacionit tonë ka të drejtë kontrolluesi me i ngritur çështjet kundërshtuese në gjykatë, vendimmarrja mundet të shkojë deri në Gjykatë të Apelit e cila është edhe instanca e fundit, ndërkaq agjencia gjithmonë do të insistojë në zbatimin e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe shkon dyfishimi i çështjes, kërkesës në ngarkesë me masë administrative ndaj

KEDS-it, te çështja e faktuarave të ujit, të mbeturinave dhe faturimeve të ndryshme që shkojnë te qytetarët të zbuluar apo të hapura. Ne kemi nisur inspektimet, nëse nuk merren masat për zarfimin e tyre, agjencia do të procedojë me ligj, rastet do të procedohen në gjykatë.

Çështja tjetër që u përmend për sensibilizimin, kemi bërë përpjeke që të jemi prezent edhe në mediat e shkuara edhe ato elektronike. Mbrojtja e të dhënave personale është kërkesë e kohës në të cilën po jetojmë. Një prej sfidave shqetësuese është çështja e internetit, vitin e kaluar më 5 qershor, është bërë një takim urgjent në Këshillin e Evropës, Agjencia Shtetërore përherë të parë ka qenë e ftuar nga sekretari i Këshillit të Evropës, nga drejtorja gjenerale për të drejta e njeriut bashkë me të gjitha autoritetet për mbrojtjen e të dhënave personale të Bashkimit Evropian, ka qenë një konferencë një ditore. Te çështja e bankave ka pasur inspektime, e kemi nisur te bankat që selinë nuk e kanë në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, kemi bërë një hap tjetër që të gjithë që marrin sms janë të detyruar si sistem bankar ta shkruajnë në fund që të dhënat personale që jepen me i poseduar edhe Banka Qendrore. Marketingu i palejuar duke shqetësuar qytetarët në telefon është në rritje e sipër, por ne, si Agjenci kemi marrë hapa konkret për parandalim e kësaj dukurie, kemi dërguar në gjykatë 16 raste të tilla, kemi pasur marketing të palejuar edhe në fushatën zgjedhore.

Anëtarësimi në organizata ndërkombëtare, Agjencia konsideron që aktet e brendshme gati i ka të rrumbullakuara, sa ne do të kemi përfitime në anëtarësimin në Organizata Ndërkombëtare, një prej përfitimeve në radhë të parë qytetari i Republikës së Kosovës. Çështja e qasjes në dokumente publike që herë-herë agjencia fokusohet si përgjegjëse për dhënien e lejes për qasjen në dokumentacion publike, që këtë mandat nuk e kemi me ligj. Inspektimet në Polici, ne e kemi bërë inspektimin e polici, tash i kemi 5 zyrtarë që merren me mbrojtjen e të dhënave personale, duke filluar nga një zyrtar që është në agjencinë e regjistrimit civil që ka të vetmen detyrë pune dhe zyrtari tjetër është në çështjen e kontrollimit ndërkufitar, në rast se me ligj është e rregulluar çështja e të dhënave biometrike mund të përdoret, nëse jo i vetmi autoritet në nivel të vendit me ligj është Agjencia Shtetërore.

Në nivelin ndërkombëtar, në konferencën e fundit është mbajtur dhe është aprovuar një dokument që rregullon transferin ndërkombëtar në mënyrë unike në nivel global. Evropa ka edhe një konventë, që ne nuk jemi nënshkruese, e kemi në fund të raportit konventën si rekomandim për deputetët e Kuvendit të Kosovës që ne duhet të jemi nënshkruese si shtet. Pyetja nga z. Qerimi, nëse kemi punëtorë nga komunitetet jo-shumicë, është një punëtor nga komuniteti serb, besoj që do të ketë mundësi punësim të barabartë edhe për komunitetet tjera.

Nuredin Ibishi- Çështja e grumbullimit, përpunimit, përdorimit, por edhe fshirjes të të dhënave, nuk e di a kanë nxjerrë udhëzim administrativ, se me ligj janë të rregulluar në mënyrë sipërfaqësore dhe sa janë të sigurt këto të dhënat tona biometrike nga shtetet ku janë prodhuar?

Ruzhdi Jashari- Një udhëzim administrativ është nënshkruar së fundi, një tjetër është te çështja e përpunimit të dhënave personale është në procedim, ndërsa çështja e përpunimit të dhënave biometrike me ligj e ka të drejtën edhe kompetencën Agjencia e Regjistrimit Civil. Sa janë të sigurt të dhënat biometritke, në rast se ne nuk e kemi atë çështje të kompetencës sonë, te mbrojtja e të dhënave personale ka mundësinë e mbrojtjes të të dhënave në rast se është prodhuar nga një kontrollues në Bashkimin Evropian, ai detyrimisht duhet të përmbush kriteret që të mund të bëjë kontrata shtet me shtet.

Kryetari- A mendoni që ligji për përgjime që pritet në miratim, ka qenë në lexim të parë është kthyer prapë në rishikim, nuk përputhet saktë në mes të Agjencisë suaj edhe Ligjit për përgjim?

Ruzhdi Jashari- Ne i kemi dhënë mendimet, lidhur me harmonizimin ligjor sepse në bazë të nenit 38 detyrimisht duhet të vinë në harmonizim në fushën e mbrojtës të të dhënave, në rast se në ligjet specifike bëhet fjalë për të dhënat personale të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Bujar Sadiku- Ndër sfidat kryesore të Agjencisë është buxheti, agjencia ka 130 mijë euro buxhet, me atë buxhet na kemi kërkuar që t'i mbyllim inspektimet dhe kontrollet në nivel vendi si dhe ambasadat që i kemi me ligj në neni 4, kemi kërkuar që t'i mbyllim edhe trajtimin e ankesave në nivel vendi, problem tjetër është edhe personeli, vitin e kaluar tri herë e kemi pasur një konkurs, kemi mungesë personale edhe pse këtë vit qëndrojmë pak më mirë.

***Kryetari** konstatoi se Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës me vota unanime, nxori këtë:*

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit të Kosovës të shqyrtojë edhe të miratojë raportin e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2014.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00.

Përgatitur nga:
Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Daut Haradinaj